

VENDIM
Nr. 28, datë 16.1.2003

**PËR LIKUIDIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN PETROLEUM CORPORATION” (APC),
SHA, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së nenit 264, të ligjit nr.7638, datë 19.1.1992, “Për shoqëritë tregtare” dhe të nenit 13, të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998, “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, me propozimin e Ministrit të ekonomisë dhe Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Likuidimin e shoqërisë “ALBANIAN PETROLEUM CORPORATION”, “APC”, sha, Tiranë, për shkak të pushimit të objektit të shoqërisë, e cila ka ushtruar veprimtari në fushën e hidrokarbureve, nëpërmjet pjesëmarrjes, së drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në shoqëritë e kontrolluara, si dhe ka realizuar bashkëpunimin tekniko-financiare të këtyre shoqërisve.

2.Aksionet dhe kuotat e kësaj shoqërie, t’u kalojnë shoqërive “ALBAPETROL”, sha, “ARMO”, sha, “SERVOCOM”, sha,”Uzina Mekanike e Naftës,”shpk, Kuçovë, “Transnafta”, shpk, Patos dhe “Uzina Mekanike”, shpk, Patos.

3.Shoqëria “Albpetrol”, sha, e cila ka si objekt kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, të veprojë si shoqëri aninime më vete.

4.Shoqëria “ARMO”, sha, e cila ka si objekt rafinimin e naftës, shpërndarjen dhe marketingun e produkteve të rafinuara, të veprojë si shoqëri aninime më vete.

5.Shoqëria “SERVOCOM”, sha, e cila ka si objekt zhvillimin e shërbimeve gjeofizike, sizmike, shpimin e puseve dhe mirëmbajtjen mekanike të pajisjeve të ndryshme, të veprojë si shoqëri anonime më vete.

6.Aksioneri i vetëm i shoqërisë “ALBPETROL”, sha, “ARMO”, sha, dhe “SERVOCOM”, sha, të jetë shteti, i përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë.

7.Shoqëritë “Uzina Mekanike e Naftës”, shpk, Patos, të veprojnë si shoqëri më vete, ku si ortak i vetëm është shteti, i përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë.

8.Të gjitha marrëfeshjet, ku palë është “APC”, sha-ja, t’u kalojnë shoqërive të mësipërme anonime dhe atyre me përgjegjësi të kufizuar, sipas objekteve përkatëse të këtyre marrëveshjeve.

9.Sistemimi i llogarive financiare dhe i detyrimeve që ka “APC”, sha-ja, të bëhet brenda tre muajve pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

10.Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

11.Vendimi nr.756, datë 26.11.1998, i Këshillit të Ministrave, “Për ristrukturimin e “ALBPETROL”, sha-së, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano